

PËRNDJEKJA E KLERIT TË KRISHTERË ORTODOKS GJATË REGJIMIT KOMUNIST

Dr. Thoma Shkira

Lektor pranë Kolegjit Universitar “Logos”, Tiranë

Email: thomashkira@yahoo.com

Abstrakt

Punimi shtjellon goditjen e modeleve të besimit të krishterë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të figurave të klerit ortodoks dhe familjarëve të tyre prej regjimit komunist. Në punim sillen fakte të përndjekjes së klerikut shkodran, peshkopit ortodoks Irine Banushi, Kryepeshkopit Kristofor Kisi dhe për likuidimin e klerikëve, të cilët, kryesisht, u shërbenin si kishtarë zonave pranë kufirit ndërshtetëror të Mitropolisë së Gjirokastrës. Gjithashtu trajtohet edhe ajo kategori e klerikëve ortodoksë të pushkatuar dhe të zhdukur. Ndër ta përmendim përmetarin at Aleksandër Lipe, portreti i të cilit u ekspozua si “Armiku i popullit” në Muzeun Ateist të Shkodrës. Gjithashtu, trajtohen profile klerikësh që u pushkatuan, me gjyq apo pa gjyq, të cilët bëjnë pjesë kryesisht në kategorinë e klerikëve ortodoksë të pushkatuar, trupat e të cilëve nuk u gjendën kurrë. Metodologjia e përdorur në shtjellimin e këtij punimi është ajo përshkruese dhe analizuese e të dhënave të konsultuara me bibliografinë përkatëse, si dhe me dokumentet e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të klerit ortodoks të përndjekur në diktaturën komuniste, kemi trajtuar kryesisht profilin e klerikëve të pushkatuar dhe të atyre që kanë vdekur në burgje. Në ndonjë rast jemi mbështetur edhe tek ndonjë intervistë të familjarëve të klerikëve të përndjekur.

Fjalë kyçe: përndjekja e klerit ortodoks, regjimi komunist, klerikë të pushkatuar dhe të zhdukur, Shqipëri

Qëllimi i punimit

Qëllimi i punimit është të trajtojë profilet e klerit ortodoks të përndjekur gjatë diktaturës komuniste, të pushkatuar dhe të vdekur në burgje, si dhe të evidentojë ndër ta personat e zhdukur.

Objektivat

Objektivi i punimit ka qenë nxjerrja në pah e përndjekjes së figurave të klerit ortodoks, kryesisht të klerikëve të pushkatuar apo të vdekur në burgje; një pjesë e të cilëve akoma deri më sot figurojnë si persona të zhdukur. Me evidentimin e emrave dhe profileve të klerikëve të përndjekur, natyrisht që shprehim nderimin ndaj tyre dhe i shërbejmë qëllimit të projektit të

Memorialit “Muri i Gjakut” në Shkodër dhe në vende të tjera, për ta pasuruar listën e viktimave të komunizmit me përfaqësues të të gjitha krahinave të Shqipërisë.

Hyrje

Shteti komunist shqiptar e luftoi besimin tek Zoti dhe bashkësitë fetare, deri sa arriti likuidimin tërësor të tyre në vitin 1967. Më pas, më 1976, Shqipëria, me Kushtetutën e RPSSH-së, u shpall si vend ateist. Një nga aspektet e goditjes së besimit tek Zoti dhe të komuniteteve fetare është goditja e klerit të tyre. Në rastin e bashkësisë së krishterë ortodokse, u përndoqën klerikë të shquar dhe me ndikim në popull. Regjimi komunist i akuzoi klerikët si mosbashkëpunues dhe si kundërshtarë politikë, si agjitues dhe propagandues të vendeve të huaja, si dhe armiq të popullit e atdheut, duke u dhënë dënime të rënda, madje edhe kapitale. Për justifikimin e dënimeve të klerikëve, ndaj tyre u ngritën akuza të sajura. Veprimet e regjimit goditën dhe stigmatizuan klerikët ortodoksë, por, njëkohësisht, edhe familjarët e tyre dhe mbarë bashkësinë shoqërore të krishterë. Mbështetur në shkallën e persekutimit, dhjetëra klerikë ortodoksë u kategorizuan në katër kategori: të pushkatuar apo të vvarë në burgje, të burgosur, të internuar dhe të izoluar. Rastet e përndjekjes së klerikëve ortodoksë të hierarkisë së lartë kishtarë, si dhe e klerikëve të tjerë të hierarkisë së ulët kishtarë të kategorisë së parë, përbëjnë një aspekt të dukshëm të goditjes së besimit dhe klerikëve.

Klerikët e hierarkisë së lartë të përndjekur në diktaturë.

Regjimi komunist, që në vitet e para të instalimit të tij në Shqipëri goditi klerikët që u konsideruan si antikomunistë dhe mosbashkëpunues. Një nga makinacionet e regjimit ishte vendosja e klerikëve pro regjimit, në krye të institucioneve fetare. Kjo ndodhi ndaj hierarkëve të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, kur në vitet e para të instalimit të regjimit komunist u arrestuan dhe u burgosën Irine Banushi dhe Visarion Xhuvani.¹ Në vitin 1949 larguan me “puç” Kryepeshkopin Kristofor Kisi (1937-1949). Që nga ky moment ai nuk i kreu më detyrat e tij klerikale dhe qëndroi i izoluar në Kishën e Shën Prokopit, pranë Liqenit Artificial të Tiranës, deri më 17 qershor 1958, kur sipas versionit zyrtar u deklarua se vdiq nga hemoragjia celebrale, por që dyshohet se vdiq i helmuar nga njerëzit e regjimit. Nga dëshmitë e njerëzve të tij të afërt, apo ato të dëshmitarëve të kohës, mbështetur edhe tek rrethanat e atëhershme historike, vërtetojmë faktin që Kryepeshkopi Kristofor Kisi është përndjekur prej regjimit, si dhe fundin e tij si martir.² Gjithashtu, ndër klerikët ortodoksë që gjatë diktaturës komuniste janë përndjekur, pushkatuar, të vdekur në burgje dhe në internime, është edhe kleriku i lartë, Episkopi Irine Banushi. Një nga figurat kryesore të përndjekjes së klerit ortodoks gjatë diktaturës komuniste është ajo e klerikut të lartë, peshkopit Irine Banushi. Ai u lind në Shkodër më 18.08.1906 dhe përpara dorëzimit si klerik mbante emrin Ilia. Arsimin fillor dhe një klasë qytetëse i kreu në Shkollën Popullore.

¹ Visarion Xhuvani, *Vepra*, ed. Pavli Haxhillazi dhe Nos Xhuvani (Tiranë: Logoreci, 2007), f. 270.

² Intervistë me Leka T., Tiranë, Prill 2018, 89 vjeç.

Ndërsa në vitin 1925 përfundoi shkollën e mesme pranë gjimnazit “Ilirikum të Françeskanëve, në Shkodër. Më pas, deri në vitin 1931, vijoi studimet pranë Seminarit Ortodoks të Cetinjes.³ Për t’u thelluar më tepër në dijet e krishtera, ndoqi Fakultetin e Teologjisë në Universitetin e Beogradit, ku dhe u diplomua në vitin 1938.⁴

Okupatori Italian e burgosi në korrik të vitit 1939 dhe më pas e internoi në Itali si të rrezikshëm, ngaqë Irineu ishte një figurë kleriku me mjaft ndikim në radhët e ortodoksëve dhe patriotëve të vendit, deri sa u lirua pas ndërhyrjes që Kryepeshkopi Kristofor Kisi bëri tek Mëkëmbësi i Përgjithshëm i Mbretit Perandor në Shqipëri, Gjeneral Pariani.⁵

Edhe pse ishte internuar nga fashistët, ai u akuzua nga komunistët si reaksionar dhe bashkëpunues me armiqët e popullit, si Gjergj Kokoshi, Dom Shtjefën Kurti dhe të tjerë priftërinj katolikë, të cilët i kishte profesorë në seminarin Katolik të Shkodrës.⁶ Me gjithë këto, Irineu nuk pranoi asnjë nga akuzat, kur thoshte: *“Nuk jam marrë asnjëherë me politikë porse gjithmonë kam shikuar detyrën time fetare”*.⁷

Gjithashtu, ishte i konsiderueshëm kontributi i tij për njerëzit në nevojë gjatë Luftës së Dytë Botërore.⁸ Qëndroi si ndihmës Episkop i Kryesisë, deri më 12 Korrik 1945, datë në të cilën Sinodit i Kishës e emëroi Episkop të Gjirokastrës, por për shkak se pushteti e ndaloi të shkonte, qëndroi në Tiranë si titullar i saj, deri në datën e arrestimit të tij, më 28 tetor 1946.⁹

Një tjetër fazë e jetës së Irineut ishte pakënaqësia dhe përballjet e tij me pushtetin e ri, i cili dënonte miqtë e tij intelektualë, si dhe kufizonte e ndërhynte politikisht haptas kundër fesë dhe autoqefalisë së Institucionit të KOASH-ës. Edhe pse më datën 12 Korrik 1945 Sinodi e emëroi Episkop të Gjirokastrës, pushteti i ri e ndaloi të shkonte, deri sa e arrestoi më 28 tetor 1946, datë

³ Qytet në Malin e Zi. *Shënim i redaktorit*.

⁴ Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë* (Tiranë: Botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, 2000), f.10.

⁵ *Dosja Formulare nr. 4180 “Irine Banushi”, Nr. Regj., Kategoria IIB Tepër Sekret*, (Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, n.d), f. 27. Shih edhe: Thoma Shkira, “Tipologjia e “Armikut të popullit” dhe sjelljes së regjimit ndaj klerit ortodoks në Shqipëri (1944-1990)”, në *Profile të Armikut të Popullit*, Konferencë Ndërkombëtare Shkencore (Tiranë: Onufri, 2021) f. 95.

⁶ *Dosja Formulare nr. 4180 “Irine Banushi”, Nr. Regj., Kategoria IIB Tepër Sekret*, (Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, n.d), f.7.

⁷ *Dosja Formulare nr. 4180 “Irine Banushi”, Nr. Regj., Kategoria IIB Tepër Sekret*, (Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, n.d), f.5.

⁸ Irine Banushi, edhe pse u titullua si peshkop i Strugës, nga Sinodi i Shenjtë, pas bashkimit të trojeve shqiptare në kohën e pushtimit italian, - siç pohon edhe vetë, - nuk shkoi të merrte detyrën, sepse ishte skeptik ndaj politikave të pushtesit. Për shkak të njohjeve personale, Irineu u ka lehtësuar jetën mjaft njerëzve, sidomos muhaxhirëve vendas dhe të huaj që lëviznin për shkak të luftës dhe u ka shpëtuar jetën shumë personave të arrestuar nga fashistët. Ai gëzonte mirënjohjen e shumë vetëve, mori falënderime edhe nga qeveria jugosllave e pasluftës, sepse u kishte shpëtuar jetën shumë malazezëve dhe serbëve të internuar dhe burgosur në vendin tonë. Shih: Beduli, *Episkop Irine Banushi, Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, f. 5-16.

⁹ Beduli, *Episkop Irine Banushi, Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale Të Shqipërisë*, f. 17.

në të cilën u privua nga çdo shërbim kishtar.¹⁰ Pasi dënohet nga gjykata e Tiranës me 5 vjet heqje lirie, më 17.04.1947, dënimin e kreu në burgun e Tiranës, deri sa më 28.04.1949 përfitoi nga një amnisti. U arrestua, dhe u dënua me pa të drejtë, dy herë me burgim, të cilat i kreu dhe krahas kësaj u izolua për disa vite të tjera prej regjimit, në disa Manastire Ortodokse të vendit.¹¹ Pas gjendjes së tij të rënduar shëndetësore, episkop Irineu izolohet në Manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Pushteti Komunist i ndaloi të drejtën e detyrës së episkopit edhe pse kërkonte që ta përdorte në funksion të ndryshimeve që kërkonte të kryente në radhët e kishës. Këto ndërhyrje krijuan pakënaqësi tek Irineu, pasi ato binin ndesh me kanonet e kishës. Pas vitit 1967, episkopi Irine Banushi banoi në qytetin e Lushnjës, ku u lejua të punonte si magazinier për tre vite dhe më pas arkëtar në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Hekurudhës, si dhe për katër vite të tjera si llogaritar i parë në Parkun e Automjeteve në Lushnjë. Ndërroi jetë në Tiranë, më 25.11. 1973.¹²

Klerikë të përndjekur të hierarkisë së ulët kishtare.

Gjatë viteve të luftës, partizanët pushkatuan këta priftërinj ortodoksë: At Dhimitër Leka, nga Kudhësi i Himarës, në prill të vitit 1944; at Jani Aristoteli, nga Dhoksati i Lunxhërisë; At Aleks Vallvi, në Sopik të Sarandës, gjatë verës së vitit 1944; At Leonidha Qirici, nga Selcka e Pogonit, në dimrin e vitit 1943; At Harallam Liti (Lame), në Krishtlindjen e vitit 1944; At Kiriako Papakiriako, nga Leshnica e Sarandës, në mesin e vitit 1944¹³ dhe Papa Pandeli Sallata, nga Lushnja.¹⁴ Pas luftës ka qenë një numër klerikësh ortodoksë të zhdukur e të dënuar për agjitacion dhe propagandë, të dënuar me pushkatim apo të vdekur në burg, familjarëve të të cilëve iu refuzua marrja e trupit të tyre të pajetë. Ata janë: At Aleksandër (Aleks) Lipe at Gjergj Suli¹⁵, at Mina Ikonimi¹⁶ at Stavro Rexho, papa Kristo Papa, papa Konstandin Bozdo, papa Theodhor Gulo. Gjithashtu, kemi dhe klerikë që vdiqën në burgje, si at Nikolla Kalojani, at Jani Kutulla,¹⁷ at Sotir

¹⁰ Po aty.

¹¹ Shkira, "Tipologjia e "Armikut të Popullit" dhe sjelljes së regjimit ndaj Klerit Ortodoks në Shqipëri (1944-1990)," f. 97-98.

¹² Po aty, f. 99.

¹³ "Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990)," *Ngjallja*, Dhjetor 2014, Nr. 12 (263), f. 3. <https://orthodoxalbania.org/2020/wp-content/uploads/2020/11/Gazeta-Ngjallja-Dhjetor-2014.pdf>.

¹⁴ "...Papa Pandeli Sallata nga Lushnja, i kthyer në unit, ish një nga aktivistët e shquar të unitizmit dhe fashizmit, në vitin 1943 u ekzekutua nga forcat partizane si spiun i italianëve; ..." Shih: "Dosja e objektit për Kryepeshkopatën e Klerit Ortodoks", F. 4, nr. 61, v. 1958, Kategoria IIB, TEPËR SEKRET *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt. 16. 06. 2017 nga AIDSSH), f. 94.

¹⁵ Dosja Formulare, Nr. 906 "At Gjergj Suli", Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr. 2, dt. 16. 06. 2017 nga AIDSSH, fl.48. Shih edhe: Thoma Shkira, "Dritëhije të stigmatizimit të klerit ortodoks në periudhën e regjimit diktatorial në Shqipëri", mbajtur në Konferencën Shkencore "Dritëhije" në Muzeu "Shtëpia me Gjethe", 23 Maj 2022, Tiranë. Botuar në "Dritëhije", Revistë Shkencore Periodike, nr. 4, Muzeu Kombëtar "Shtëpia me Gjethe", Tiranë, 2022, f. 98-101.

¹⁶ Grup Autorësh, *I Ethniki Elliniki Mionotita Voriu Ipiru stin Alvania (Ioannina, 2014)*, f. 360-364.

¹⁷ "At Nikolla Kalojani, nga fshati Fanar i Vurgut. U ekzekutua në mënyrë mizore në mars 1949. At Jani Kutulla nga Himara. U ekzekutua gjatë hetimeve, në prill 1968". Shih: "Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990)", f. 3.

Konomi, at Jorgji Sula, at Anastas Thanasi, at Aleks Ikonomi, at Evangjel Boçi, at Petro Draçova¹⁸ dhe i vdekuri në internim, në Kampin e Vloçishtit, At Ligor (Grigor) Zografi.¹⁹ Në lidhje me situatën e përndjekjes së at Aleksandër (Aleks) Lipe mund të përmendim faktin se pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, kur përmetarët votuan tërësisht “kundër” diktaturës, më 9 Shkurt 1946 at Aleks Lipe arrestohet së bashku me të tjerë përmetarë, duke e mbyllur në burgun e Gjirokastrës dhe duke e akuzuar për agjitacion dhe propagandë. Në gjyqin kundër 8 personave të arrestuar, nga Përmeti, at Aleksin u dënua me vdekje, për tradhti të lartë, ndërsa të tjerët me burgime të gjata. Ekzekutohet gjatë natës së 4 korrikut të 1946 dhe trupi i tij nuk u gjet kurrë. Më vonë, si bashkëpunëtor i at Aleksandër Lipes²⁰ u akuzua edhe prifti i Zhepës së Përmetit, at Mina Ikonomi.

At Mina Ikonomi është prifti tjetër me emër të mirë ndër banorët e zonës dhe kryesisht të juridiksionit kishtar të Mitropolisë së Gjirokastrës. Studioi në Greqi për teologji, ndërsa në Francë studioi për mësues matematike. Qe njohës i disa gjuhëve të huaja. Arrestohet në vitin 1947 dhe dënohet e pas pak kohe vdes në burgun e Gjirokastrës. Familjarët, pas arrestimit të Papa Mina Ikonomit, as nuk mësuan nëse u dënua, si dhe ku ndodhet trupi i tij.²¹ Në muajin maj të vitit 1976, një grupi studentësh të vitit të dytë të fakultetit të Histori-Gjeografisë të Shkollës Pedagogjike, Gjirokastër, u nis për ekspeditë në veri të Shqipërinë, ku vizitoi edhe Muzeun Ateist në Shkodër. Në muze u ndodh Irakli Thanasi nga Kaludhi i Përmetit, i datëlindjes 5 Maj 1955, që ishte në rreth krushqie me priftin e pushkatuar At Aleks Lipen. Në momentin e vizitës së tij nëpër pavijonet e muzeut u gjend papritur përballë me fotografinë e At Aleksit, e cila mbante shpjegimin “Armik i popullit”. Reagoi menjëherë duke kthyer kokën pas, sepse iu kujtua stigmatizimi i tij shumëvjeçar, qysh nga viti 1959, kur motra e tij e madhe u martua me djalin e vëllait të At Aleksit, si dhe “njolla në biografi”, pasojat e së cilës i vuajti gjatë gjithë jetës. Ai kujton se, kur përfundoi klasën e tetë në vendlindje, u mblodh këshilli popullor i fshatit dhe i komunikoi vendimin për të patur të drejtën e arsimimit në Shkollën Pedagogjike në Gjirokastër. Ditën tjetër shkoi dhe kreu analizat mjekësore në Përmet, të cilat nevojiteshin për të shkuar në shkollë dhe kur u kthye në fshat i komunikuan përsëri se nuk do të shkonte me studime, për shkak se kishte lidhje familjare me armikun e pushkatuar, At Aleksin.²² Përndjekja e paprecedentë e regjimit dhe njëkohësisht stigmatizimi ndaj familjarëve të priftit të pushkatuar At Aleksit

¹⁸ “At Evangjel Boçi, nga Çarçova e Përmetit. Vdiq në hetime nga presioni psikologjik dhe dhuna fizike në Dhjetor 1967. At Petro Draçova, nga Rrëza e Përmetit. U burgos më 1946 dhe vdiq disa vite më vonë në burg. Shih: “Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990)”, f. 3-4.

¹⁹ Thoma Shkira, “Dritëhije të stigmatizimit të klerit ortodoks në periudhën e regjimit diktatorial në Shqipëri,” në *Dritëhije*, nr. 4 (Tiranë: Muzeu Kombëtar “Shtëpia me Gjethe”, 2022), 92–102.

²⁰ Xhaferr Sadiku, “Sigurimi i Shtetit, si Sigurim i Pushtetit dhe Përcaktues i Fatit të Njeriut në Shqipërinë Komuniste: (Veprimtaria e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Përmetit),” *Dritëhije*, no. 6, (Tiranë: Muzeu Kombëtar “Shtëpia me gjethe”, 2024), f. 131-159.

²¹ Radio Ngjallja, “Jeta ime nuk ka kuptim pa Krishtin dhe Shën Marinë”: Si u martirizua pa gjyq Atë Mina Ikonomi?, YouTube, qershor 2025, <https://www.youtube.com/watch?v=NnjHm0Lrxdl>.

²² Intervistë me Irakli Thanasin. Tiranë, Tetor 2019, 63 vjeç.

vërehet edhe nga historia e jetës së tyre, të cilët për të bërë një jetë më të qetë dhe në praninë e njerëzve që nuk i njihnin nga afër, u detyruan të largohen nga fshati Kaludh dhe të ikin larg, siç ndodhi edhe me vajzën e priftit dhe dy nipërit e tij, në vitet 60-70.

Në vitet 1960, lufta e klasave ndaj kësaj kategorie njerëzish, të cilësuar me njollë nga sistemi komunist, i detyroi që të ndaheshin nga krushqitë dhe njerëzit të mos i afronin e të mos pranoreshin në gosti, dasma, fejesa, darka të shtruara, kur shkonte dikush ushtar, si dhe në çdo veprimtari familjare dhe shoqërore. Personat me njollë në biografi rrezikonin mosanëtarësimin në parti. Përndjekja ndaj klerit dhe besimtarëve nuk mbaronte me brezin e parë, por edhe të dytin e me radhë, ashtu sikundër edhe ndaj kushërinjve të tyre. E bija e At Aleksit, me 5 fëmijë, u largua në Shkodër në vitin 1961. Gjithashtu, nipi i priftit nga vëllai, Dhimosten Lipe, u largua në Bizë të Martaneshit dhe punonte në sharrë, në vitet 1970, vetëm e vetëm që të mos qëndronte në ambientin stigmatizues të fshatit. Njëkohësisht, edhe Kosta Lipe, nipi i motrës së At Aleksit, u detyrua të martohej dhe të krijonte familje në një fshat të Dropullit, për t'u larguar nga ambienti i paduruar. Natyrisht, ishin lajkatarët e regjimit, të cilët shpeshherë mendonin se bënë mirë kur silleshin keq me ta.²³

Nga kërkimi i deritanishëm u evidentuan shtatë klerikë ortodoksë të përndjekur dhe të zhdukur. Tre prej tyre janë at Aleksandër Lipe, at Gjergj Suli dhe at Mina Ikonimi, që u trajtuan më sipër. Në vijim po përmendim dhe katër të tjerët:

At **Stavro Rexho** u lind më 1903 në Dhivër të Sarandës, prindër të cilit ishin Panajoti dhe Stamatos, nga një shtresë e varfër. Arsimin fillor e kreu në fshatin e lindjes. U martua me Dhimitrullën, me të cilën patën pesë fëmijë. Më 1928 emërohet mësues në fshatin Gravë, në shkollën fillore në gjuhën greke, ku shërbeu pak vite. Në 1932 u vesh prift dhe caktohet me detyrë në fshatin Llazar-Kallcat të Sarandës, ku shërbeu për dy vite. Një vit në Dhivër dhe më pas shërbeu si prift në Nivicë-Bubar, ku qëndroi për 13 vite. Në kohën e luftës doli vullnetarisht partizan në radhët e ushtrisë, me forcat e Frontit. Në vitin 1949 shërben si prift në Dhivër, Aliko, Mursi dhe për pak kohë në Mesopotam. At Stavro Rexho, për arsye të paqena, u mbyll, së pari, në burgun e Gjirokastrës, në vitet 1946-1949 dhe më pas u burgos në burgun e Burrelit, më 1963, duke ndenjur aty deri sa vdiq, në vitin 1966. Familjarët dyshuan se atë e helmuan në burg, për çka ata e kërkuan trupin e tij, por morën përgjigje negative. Akoma rezulton person i zhdukur. At Stavro Rexho, siç e referuam, u arrestua në Gjirokastër, më 20 janar të vitit 1946, ku u gjykua dhe u dënua me tre vite burgim për tradhti të naltë, së bashku me 18 persona të tjerë. Ndër ta ishin dhe dy priftërinj të tjerë, Papa Jani Dashi, nga Çuka e Sarandës dhe Papa Kristo Papa, nga Sopiku i Sarandës, të cilët u dënuan secili me 30 vite heqje lirie.

²³ Intervistë me Irakli Thanasin. Tiranë, Tetor 2019, 63 vjeç.

Papa **Kristo Papa**, nga Sopiku (rajoni i Delvinës). Dokumentet e Fondit Radio Evropa e Lirë (Radio Free Europe) vdekjen e tij e konsiderojnë si pasojë e torturave çnjerëzore të papa Kristo Papës në burgun e Gjirokastrës.²⁴ Ai ishte antikomunist, prandaj edhe u arrestua e bëri 6 vite burg nën tortura çnjerëzore, nga të cilat përfundoi i vrarë me akuzën “Armik i popullit”, në burgun e Burrelit, në vitin 1951. Trupi nuk iu gjend.

Papa Kostandin Bozdo, nga Koshovica. U arrestua në muajin qershor të vitit 1963, i akuzuar nga regjimi si tradhtar ndaj atdheut dhe pas gjashtëmbëdhjetë muaj torturash çnjerëzore u ekzekutua në Tiranë, në një vend të panjohur deri më sot, më 30 shtator 1964.²⁵

Papa **Theodhor Gulo**, nga Sotira. U arrestua në fshatin Koshovicë, më 28.09.1947. Pas 10 muaj torturash çnjerëzore në burgun e Gjirokastrës, gjatë të cilave e detyruan që të firmoste akuzat e ngritura pa asnjë bazë, nga gjykata e Gjirokastrës dënohet me 18 vite burg, me vite pune të detyruar, konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si dhe humbjen për 5 vjet të së drejtës për të votuar. Pas pak kohësh e çuan në burgun politik të Burrelit, ku nga torturat e shumta u sëmur rëndë dhe vdiq në burg më 11.07.1951. Familjarët i kërkuan eshtrat e tij, por përgjigjja ishte negative.

Sugjerime dhe Rekomandime.

Emrat e klerikëve ortodoksë të përndjekur gjatë diktaturës komuniste: Kryepeshkopi Kristofor Kisi, episkopët Irine Banushi dhe Visarion Xhuvani, priftërinjtë ortodoksë të vrarë nga komunistët gjatë viteve të luftës: at Dhimitër Leka, at Jani Aristoteli, at Aleks Vallvi, at Leonidha Qirici, at Harallam Liti (Lame), at Kiriako Papakiriako, papa Pandeli Sallata, si dhe të priftërinjve të tjerë të pushkatuar dhe vdekur në burgje, ata të zhdukur dhe ata pa varr: at Aleksandër Lipe, at Gjergj Suli, at Mina Ikonimi, At Stavro Rexho, papa Kristo Papa, papa Konstandin Bozdo, papa Theodhor Gulo, at Nikolla Kalojani, at Jani Kutulla, at Sotir Konomi, at Jorgji Sula, at Anastas Thanasi, at Aleks Ikonimi, at Evangjel Boçi, at Petro Draçova dhe at Ligor (Grigor) Zografi, meritojnë të renditen në Memorialin “Muri i gjakut” në Shkodër, si edhe në memorialet që mendohet të ngrihen në vende të tjera në Shqipëri.

Numri i më tepër se 600 viktimave të regjimit komunist, në Shkodër dhe rrethinat e saj, e lartëson këtë vend në simbol të qëndresës antikomuniste me vlera dhe përmasa kombëtare.

²⁴ Bejtullah Destani, *Dosja amerikane për Shqipërinë komuniste: Komunizmi shqiptar sipas dokumenteve të Radio Free Europe* (Prishtinë: Artini, 2023), f. 164.

²⁵ Dosja Formulare, Nr. 329 “Kosta Bozdo”, Nr. Regj., Kategoria IIB TEPËR SEKRET, *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr. 6, dt. 02. 06. 2023 nga AIDSSH), f. 7-19.

Do të përbënte faktor përbashkues kombëtar vendosja dhe përjetësimi në Memorialin “Muri i gjakut” në Shkodër dhe në vende të tjera të Shqipërisë i emrave të të gjithë këtyre klerikëve ortodoksë, të përndjekur dhe të përfshirë në këtë punim.

Mendoj se Memoriali “Muri i gjakut” në Shkodër duhet të kthehet në simbolin kombëtar të qëndresës së viktimave të komunizmit, ashtu siç Muzeu Ateist i Shkodrës përbënte muzeun kombëtar të ateizmit. Le ta ilustronim me një shembull që është i përfshirë në emrat e martirëve të Kishës Katolike. Nga njëra anë, martirit të Kishës katolike Dom Dedë Maçaj, famullitar i Shkodrës, që regjimi e ekzekutoi brutalisht gjatë shërbimit të tij ushtarak në Përmet,²⁶ meriton t’i vendoset emri në Memorialin “Muri i gjakut” në Shkodër, por njëkohësisht meriton të vendoset edhe në Memorialin e “Muri i gjakut” në Ersekë apo dhe më në jug të Shqipërisë. Nga ana tjetër, disa nga familjarët e martirit të Kishës Ortodokse at Aleksandër Lipe, që u përndoq në Përmet dhe u pushkatua në Gjirokastrë, për t’i shpëtuar stigmatizimit të vazhdueshëm, u larguan dhe u vendosën në Shkodër, por, siç u trajtua në punim, të afërmit dhe trashëgimtarët e tij u përballën përsëri me stigmatizimin, pasi fotografia e At Aleksandrit u ekspozua në Muzeun Ateist të Shkodrës me shpjegimin “Armik i popullit”. Sigurisht, që emri i tij meriton të renditet në viktimat e komunizmit në Shkodër. Po ashtu, edhe vendosja në Memorialët “Muri i gjakut” e emrave të të gjithë klerikëve ortodoksë të përndjekur, padyshim që do të siguronte përkujtimin dhe nderimin tyre si për të gjitha viktimat e komunizmit.

Përfundime

Diktatura komuniste në Shqipëri përndoqi me dhjetëra klerikë ortodoksë. Klerikët e pushkatuar dhe të vdekur në burgje, apo internime, të përmendur dhe trajtuar në këtë punim, janë njëzet e gjashtë persona. Gjatë viteve të luftës u vranë nga komunistët 7 klerikë ortodoksë. Ndërsa gjatë diktaturës komuniste u pushkatuan dhe vdiqën në burgje edhe 19 klerikë ortodoksë. Ndër ta, tre ishin në funksione të larta kishtare, siç ishin Kryepeshkopi Kristofor Kisi, episkopi Irine Banushi dhe mitropoliti Visarion Xhuvani.

Regjimi donte që klerikëve të pushkatuar t’u harrohej emri, por stigmatizimi ndaj familjarëve të tyre bënte që vazhdimisht të kujtoheshin për keq emrat e klerikëve të përndjekur. Kjo ndodhi me familjarët e priftit të pushkatuar Aleksandër Lipe, ku disa prej tyre, për shkak të stigmatizimit që u bëhej u “arratisën” brenda vendit, duke u larguar nga fshati i tyre dhe duke shkuar në vende të tjera të largëta, me pretendimin se do të bënin një jetë më të mirë, duke jetuar me njerëz të cilët nuk e njihnin biografinë e tyre. Familjarët e klerikëve të përndjekur ishin nga më të stigmatizuarit gjatë atij sistemi, duke u privuar edhe nga të drejtat e tyre njerëzore, siç ishte, për shembull, e drejta për arsim, duke i penalizuar madje edhe në vlerësimin për

²⁶ Di Pinto At Leonardo, *Imzot Vincenç Prennushi me shokë martirë: Profil historik hagiografik*, vol. I (Shkodër: Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër – Pult, 2016), f.179-193.

dijet e fituara dhe, në shumë raste, edhe pse ata e kishin kryer me shumë sukses shkollimin e mesëm të përgjithshëm, nuk u jepej e drejta për vazhdimin e shkollës së lartë. Kur rriteshin, pasardhësit e kuptonin më mirë situatën dhe detyroheshin të migronin nga vendi i tyre dhe nga njerëzit e tyre të dashur. Klerikëve ortodoksë iu sajuan akuza, kryesisht për agjitacion dhe propagandë. Ata u pushkatuan dhe u burgosën dhe një pjesë prej tyre i kanë trupat ende të pagjetur. Familjarët morën përgjigje negative, kur kërkuan trupat e tyre të pajetë. Gjithashtu, klerikët ortodoksë të përndjekur përjetuan tortura nga më çnjerëzoret. Ndër ta, për Kryepeshkop Kristofor Kisin dhe at Stavro Rexhon, familjarët dhe të intervistuarit mendojnë se janë helmuar prej njerëzve të diktaturës.

Padyshim që këta klerikë të përndjekur nuk pranuan të bëheshin vegla të regjimit dhe të politikës së kohës, duke qëndruar me kurajë dhe duke ruajtur parimet e tyre të krishtera e qytetare, deri në fundin e tyre si martirë. I përjetshëm kujtimi i tyre!

Bibliografia

- Literaturë

1. At Leonardo Di Pinto. *Imzot Vincenç Prennushi me shokë martirë: Profil historik hagiografik*. Vol. I. Shkodër: Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër – Pult, 2016.
2. Beduli, Kristofor. *Episkop Irine Banushi, Martir i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë*. Tiranë: Botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, 2000.
3. Destani, Bejtullah. *Dosja amerikane për Shqipërinë komuniste: Komunizmi shqiptar sipas dokumenteve të Radio Free Europe*. Prishtinë: Artini, 2023.
4. Grup Autorësh. *I Ethniki Elliniki Mionotita Voriu Ipiru stin Alvania*. Ioannina, 2014.
5. Kosta, Lipe. *Papa-Aleksi, Aleksandër Lipe (Kalludhi)*. Athinë: ELIKRANON Printing & Publishing Company, 2018.
6. Suli, Jeta Gjergj, dhe Llukan Serafim Stavro. *At Gjergj Suli, atdhetar dhe klerik i shquar*. Gjirokastër: Argjiro, 2014.
7. Thoma Shkira, *Bashkësia Ortodokse dhe Shteti Komunist Shqiptar (1944-1990)*, Disertacion i pabotuar, Tiranë: 2022.
8. Visarion Xhuvani, *Vepra*, përgatitur nga Pavli Haxhillazi dhe Nos Xhuvani. Tiranë: Logoreci, 2007.

- Artikuj në revista

1. Shkira, Thoma. “Tipologjia e "Armikut të popullit” dhe sjelljes së regjimit ndaj klerit ortodoks në Shqipëri (1944-1990).” Në *Profile Të Armikut Të Popullit - Konferencë Ndërkombëtare Shkencore*, edited by Ornela Arapi. Tiranë: Onufri, 2021.

2. Shkira, Thoma. “Dritëhije të stigmatizimit të klerit ortodoks në periudhën e regjimit diktatorial në Shqipëri.” Në *Dritëhije*, 4:92–102. Tiranë: Muzeu Kombëtar “Shtëpia me Gjethe,” 2022, f. 92-102.
3. Sadiku, Xhaferr. “Sigurimi i Shtetit, si Sigurim i Pushtetit dhe Përcaktues i Fatit të Njeriut në Shqipërinë Komuniste: (Veprimtaria e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Përmetit).” *Dritëhije*, no. 6, Tiranë: Muzeu Kombëtar “Shtëpia me gjethe”, 2023, f. 131-159.
4. Suli, Thoma. *Të zhdukur nga diktatura: Dëshmojnë familjarët*. f. 77-87, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë: Onufri, 2022.
5. Tasi, Lekë. “70 vjet më parë At Aleks Lipe, i ekzekutuar nga diktatura.” *Revista Periodike Kërkim*, no. 15 (2017).

- Materiale arkivorë

1. “Dosja e objektit për Kryepeshkopatën e Klerit Ortodoks”, F. 4, nr. 61, v. 1958, Kategoria IIB, TEPËR SEKRET. *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt. 16. 06. 2017 nga AIDSSH), f. 94.
2. Dosja Formulare, Nr. 329 “Kosta Bozdo”, Nr. Regj., Kategoria IIB TEPËR SEKRET, *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr. 6, dt. 02. 06. 2023 nga AIDSSH).
3. Dosja Formulare, Nr. 906 “At Gjergj Suli”, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr. 14, dt. 17. 08. 2018 nga AIDSSH).
4. Dosja Formulare, Nr. 947 “Irine Banushi”, Nr. Regj., Kategoria IIB TEPËR SEKRET, *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*, (Deklasifikuar me vendimin Nr.10, dt. 26. 03. 2024 nga AIDSSH).
5. Dosja Formulare nr. 4180 “Irine Banushi”, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, *Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit*. (Deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt. 16. 06. 2017 nga AIDSSH).

- Gazeta

1. Ngjallja. “Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990).” Dhjetor 2014, Nr. 12 (263).
<https://orthodoxalbania.org/2020/wp-content/uploads/2020/11/Gazeta-Ngjallja-Dhjetor-2014.pdf>.

-Webfaqe

1. Radio Ngjallja. “Jeta ime nuk ka kuptim pa Krishtin dhe Shën Marinë”: Si u martirizua pa gjyq Atë Mina Ikonomi?” YouTube, qershor 2025.
<https://www.youtube.com/watch?v=NnjHm0LrxdI>.

- **Intervista gojore**

2. Intervistë me Irakli Thanasin. Tiranë, Tetor 2019, 63 vjeç.
3. Intervistë me Leka T., Tiranë, Prill 2018, 89 vjeç.